



Shoqata Kombëtare e  
Punonjësve Socialë



Embassy of the United States of America  
Tirana, Albania

# RAPORT MONITORIMI

---

“TRANSPARENCA DHE PJESMARRJA E QYTETARËVE  
NË QEVERISJEN VENDORE TË BASHKISË DURRËS,  
SHKODËR DHE KORÇË”

---

Titulli:

RAPORT MONITORIMI “TRANSPARENCA DHE PJESMARRJA E QYTETARËVE  
NË QEVERISJEN VENDOR TË BASHKISË DURRËS, SHKODËR DHE KORÇË”

Përgatitur nga:

Eliona Bimbashi

Marsela Allmuça

Raporti i monitorimit “Transparenca dhe pjesmarrja e qytetarëve në qeverisjen vendor të Bashkisë Durrës, Shkodër dhe Korçë”, është realizuar në kuadër të projektit “Monitorimi i programeve të transparencës në nivel lokal për një qeverisje demokratike”, i zbatuar nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci. Opinioni i shprehur në të jo domosdoshmërisht është opinion i Komisionit për Demokraci”.

Kontribuan në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe monitorimin në terren të programeve të transparencës: Çelestina Muçollari – Shkodër; Teuta Nasto - Korçë dhe Shqiponja Danaj - Durrës.

Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni me:

Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë - Shqipëri

Rr. Shyqyri Ishmi, Nr.62/I, Tiranë

Website: [www.albanian-nasw.com/](http://www.albanian-nasw.com/)

Email: [Info@albanian-nasw.com](mailto:Info@albanian-nasw.com)

## PËRMBAJTJA

1.	<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
-	E drejta për informacion	
-	Projekti “Monitorimi i programeve të transparencës në nivel vendor për një qeverisje demokratike” .....	12
2.	<b>METODOLOGJIA .....</b>	<b>15</b>
-	Qasja Metodologjike	
-	Përshkrimi i instrumentave të monitorimit .....	15
3.	<b>ANALIZA ETË DHËNAVE .....</b>	<b>18</b>
-	Monitorimi i kategorive të informacionit pa kërkesë .....	18
-	Monitorimi i mbledhjeve të këshillit bashkiak .....	30
-	Analiza e intervistave me qytetarët .....	37
4.	<b>KONKLUZIONE .....</b>	<b>48</b>
-	Konkluzione për Bashkinë Durrës .....	48
-	Konkluzione për Bashkinë Shkodër .....	49
-	Konkluzione për Bashkinë Korçë .....	51

5. **Rekomandime** .....53

**Bibliografi** ..... 56

**Ankese**

- **Aneks 1:** Format bazë për monitorimin e programeve të transparencës ..... 57
- **Aneks 2:** Udhëzues për monitorimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak ..... 62
- **Aneks 3:** Intervistë me qytetarët ..... 65

## LISTA E SHKURTIMEVE

**SHKPS** Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social

**NJQV** Njësi e Qeverisjes Vendore

**QV** Qeverisja Vendore

**NJA** Njësi Administrative

**KB** Këshilli Bashkiak

**OJF** Organizata Jo fitimprurëse



## I. HYRJE

Qeverisja vendore është forma qeverisese më pranë qytetareve e cila krijon, mban dhe menaxhon marrëdhënie më të afërta me ta. Bazuar në këtë filozofi, autoritetet vendore duhet ti kushtojnë një vëmendje të veçantë dhe të kenë prioritet marrëdhëniet me publikun dhe informimin e tij të vazhdueshëm.

Me reformen e re territoriale rezultojnë se distanca mes autoriteteve lokale dhe qytetareve është bërë më e madhe, pasi aktualisht NJQV-të mbulojnë një territor më të madh dhe shpeshherë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Përveç strukturës së re dhe stafit të ri të rekrutuar, NJQV-ve iu mungojnë gjithashtu modele të pershtatshme të përfshirjes së qytetareve në procesin e vendimmarrjes.

E drejta e qytetareve dhe shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes buron nga një grup parimesh të një sistemi politik demokratik, garantuar nga e drejta për informim të lirë publik, e drejta për peticion ndaj autoriteteve, e drejta për të propozuar ligje, etj.

Në të njëjtën kohë, bazuar në ligjin Nr. 30/2015 (i amenduar) "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale" në kapitullin VI të të

cilit "Transparenca, keshillimi dhe pjesëmarrja qytetare"; NJQV -të kanë detyrimin ligjor të sigurojnë transparencë në nivel vendor (Neni 15), konsultime publike (Neni 16), mbledhje të hapura të këshillit bashkiak (Neni 17), seanca këshillimi me komunitetin ( Neni 18), e drejta për peticion, apel dhe pyetje (Neni 19), e drejta për nisma qytetare (Neni 20).

### ***Më konkretisht lidhur me transparencën:***

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
- Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.<sup>1</sup>

### ***Për Konsultimin publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV):***

- Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.<sup>2</sup>

### ***Lidhur me mbledhjet e Këshillit Bashkiak:***

- Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së

---

1 Neni 15: Transparenca e veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore

2 Neni 16: Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore



përcaktuar në rregulloren e këshillit.

- Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.<sup>3</sup>

### ***Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"***

Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", rregullon në mënyrë të hollësishme të drejtën e informimit dhe realizimin e saj në praktikë, duke përcaktuar edhe detyrimet që burojnë nga ligji për organet publike në nivel qendror apo vendor, si dhe afatet e procedurat që duhet të respektohen në realizimin e kësaj të drejte. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

### ***Informacioni publik***

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Nga ana e tij, Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë

3 Neni 17: Mbledhjet e këshillit të bashkisë

një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.<sup>4</sup>

## Programi i Transparencës

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik; b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.<sup>5</sup>

## Kërkesa për informacion

Kërkesa për informacion bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik

4 Neni 3, E drejta e informimit, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit

5 Neni 4, Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencies, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit

qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet. Kërkesa për informacion duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- d) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- e) çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.<sup>6</sup>

## **Afatet**

Autoriteti publik trajton kërkesën për informacion, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brënda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim. Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.

### **Regjistri i kërkesave**

Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i

---

6 Neni 11, Kërkesa për informim, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit

kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistrë.<sup>7</sup>

## **Ankimi administrative**

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditësh. Kur e shih të përshtatshme Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. Komisioneri kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.<sup>8</sup>

## **Projekti: "Monitorimi i programeve të transparencës në nivel vendor për një qeverisje demokratike"**

Projekti "Monitorimi i programeve të transparencës në nivel vendor për një qeverisje demokratike" është një projekt një vjeçar i mbështetur nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë i zbatuar nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social (NASW Albania) në tre bashki të vëndit, Durrës, Shkodër dhe Korçë.

Objektivat kryesore të projektit ishin: (i) Të monitorojë zbatimin

7 Neni 8, Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit

8 Neni 24, Procedurat për shqyrtimin e ankesave, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit

e planeve të transparencës dhe pjesmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në 3 bashki të vendit (Durrës, Shkodër, Korçë) për një periudhë 6 mujore; (ii) Të advokojë me autoritetet vendore për rëndësinë e transparencës dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje; (iii) Të informojë qytetarët lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes; (iv) Të forcojë demokracinë në nivel vendor nëpërmjet rritjes së transparencës dhe aksesit të qytetarëve në vendimmarrje.

Në kuadër të projektit janë zhvilluar një sërë aktivitetesh të cilat kishin në fokus përmirësimin e qeverisjes demokratike në nivel vendor si: Monitorimi i programeve të transparencës, Seminare advokuese me autoritetet lokale, Workshop-e me palët e interesuara për nxitjen e tyre në vendimmarrje, Forume të hapura me qytetarët, krijimin e forumeve online, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese.

Target grupet e projektit ishin qytetarët e tre Bashkive të vendit Durrës, Shkodër dhe Korçë, punonjësit e këtyre Bashkive dhe aktorë të tjerë vendorë si përfaqësues të OJF-ve vendore, bizneseve, institucioneve publike të niveleve të ndryshme, atyre fetare apo private.

Përfituesit final në planin afatgjatë të këtij projekti janë qytetarët e Bashkive të targetuara në një nivel më të gjërë.

Projekti është zbatuar në tre zona gjeografike të mbuluara nga tre bashki të mëdha (Durrës, Korçë, Shkodër) të cilat kanë ndërmarrë iniciativa lidhur me transparencën dhe kanë hartuar programet e transparencës sipas parashikimeve dhe të Ligjit për të drejtën e informimit.

**Raporti i monitorimit "Transparenca dhe pjesmarrja e qytetarëve në qeverisjen vendore të Bashkisë Durrës, Shkodër dhe Korçë"** paraqet një analizë të situatës së zbatimit të programeve të transparencës në tre bashkitë e vendit (Bashkia Durrës, Shkodër dhe Korçë) të bazuar në monitorimin 6 mujor të informacionit që bashkitë kanë bërë publik për qytetarët në çështjet

e mëposhtme: lloji i informacionit, përmbajtja, kanalet e komunikimit, monitorimi i mbledhjeve të këshillit bashkiak si edhe opinionet e qytetarëve nëpërmjet intervistave gjysëm të strukturuar. Në fund të raportit janë paraqitur konkluzione për secilën Bashki bazuar në të dhënat e mbledhura nga procesi i monitorimit. Gjithashtu raporti ofron rekomandime të përbashkëta për bashkitë e targetuara dhe grupet e interesit duke qenë se u identifikuan problematika dhe nevoja të ngjashme për të përmirësuar situatën e transparencës në nivel vendor.

## METODOLOGJIA

Bazuar në qëllimin e projektit dhe në parimet e qeverisjes së mirë në nivel vendor, monitorimi 6 mujorë synoi vlerësimin e transparencës së Bashkisë Durrës, Shkodër dhe Korçë lidhur me zbatimin e programeve që këto bashki kanë hartuar duke përfshirë kategoritë e informacionit që njësitë e qeverisjes vendor bëjnë publike me dhe pa kërkesë pranë mjediseve të tyre, faqeve zyrtare në internet apo median lokale, etj. Monitorimi u realizua nga 3 monitorues vendorë të trajnuar dhe u zhvillua në terren gjatë periudhës kohore Janar – Qershor, 2017.

Metodologjia e monitorimit është hartuar në përputhje të plotë me objektivat e kësaj iniciative për të ofruar një monitorim të pavarur, objektiv dhe të paanshëm të zbatimit të programeve të transparencës që secila nga bashkitë ka hartuar.

### **Instrumentat e monitorimit**

Për realizimin e monitorimit janë përdorur tre instrumenta bazë të shpjeguara më poshtë:

- 1) Format bazë për monitorimin e programeve lokale të transparencës. Hartimi i formatit është bazuar në Ligjin për

të Drejtën e informimit dhe programet e transparencës të 3 bashkive të targetuara. Ky format bazë u përdor nga monitoruesit përgjegjës për secilën Bashki për mbledhjen e të dhënave në 5 fushat e identifikuar paraprakisht: 1.1) Monitorimi i kategorive të informacionit pa kërkesë; 1.2) monitorimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në mbledhjet e këshillit; 1.3) publikimi i vendimeve të mbledhjeve të këshillit bashkiak në vënde publike dhe të aksesueshme nga publiku 1.4) ndërmarrja e iniciativave civile, kërkesat nga qytetarët për institucionet e QV; 1.5) Marrja në konsideratë e peticioneve, kërkesave dhe përgjigja në kohë e tyre sipas kohës së parashikuar.

- 2) Udhëzues për monitorimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak në të cilën parashikohen çështjet të cilat duhet të monitorohen gjatë mbledhjeve të këshillit bashkiak, si: çështjet e diskutuara dhe ndarja e diskutimit, pjesëmarrja, ndjekja e axhendës si dhe çështjet gjinore në diskutim. Në total janë monitoruar 9 mbledhje të KB, më specifikisht 3 mbledhje të KB Durrës (Janar, Mars, Qershor), 4 mbledhje të KB Shkodër (Shkurt, Mars, Prill, Qershor) dhe 2 mbledhje të KB Korçë (Shkurt, Prill).
- 3) Intervista gjysëm e strukturuar me qytetarët për të marrë perceptimet dhe vlerësimet e tyre mbi pjesëmarrjen, transparencën dhe qeverisjen e mirë. Intervistat janë zhvilluar gjatë muajit Prill, në total 60 intervista, 20 për secilën Bashki me qytetarë mbi 18 vjeç sipas një përzgjedhje të qëllimshme. Kriteret e përzgjedhjes për të intervistuarit ishin:
  - banor mbi 18 vjeç i bashkisë respektive;
  - të paktën 1 herë kontakt me bashkinë gjatë dy viteve të fundit;
  - gadishmëria për tu përgjigjur.

Intervista përmban pyetje të lidhura me nivelet, burimet dhe kategoritë e informacionit, nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje, vlerësimin e efektivitetit në adresimin e nevojave dhe kërkesave qytetarët për mirëqeverisje.



Intervistat u realizuan ballë për ballë me të intervistuarit, në mjediset e pritjes së qytetarëve pranë bashkive përkatëse dhe kohëzgjatja e realizimit të secilës varioi në 30-40 minuta.

Analiza e të dhënave u realizua nga eksperti i metodologjisë nëpërmjet përpunimi sasior dhe cilësor të tyre, duke identifikuar çështjet kryesore dhe paraqitjen e tyre sipas kategorive të përcaktuara paraprakisht.

Kanalet e informacionit të monitoruara gjatë periudhës 6 mujore ishin faqet zyrtare në internet (websit-e) të bashkive respektive, faqet e tyre zyrtare në facebook, njoftimet në median lokale dhe njoftimet e publikuara në mjediset e bashkisë apo në zyrat me një ndalesë (one stop shop).

## 3. ANALIZA E TË DHËNAVE

### 3.1 MONITORIMI I KATEGORIVE TË INFORMACIONIT PA KËRKESË

Një nga kategoritë e monitoruara në periudhën Janar - Qershor 2017 për të tre bashkitë ishin kategoritë e informacionit sipas Ligjit për të drejtën e informimit që çdo institucion publik duhet të vërë në dispozicion të publikut pa kërkesë. Sipas monitorimit rezultoi se në të tre bashkitë janë paraqitur një pjesë e mirë e kategorive të informacionit që parashikohen në ligj, por shpeshherë ky informacion është i cunguar, pa të dhëna të hollësishme në mënyrë që të jetë i kuptueshëm dhe domethënës për publikun. Faqa zyrtare në internet është instrumenti kryesor për paraqitjen e këtyre informacioneve, por në pak raste edhe mediat sociale apo njoftimet e publikuara në mjediset e bashkisë.

Disa nga kategoritë e informacionit për të cilat autoriteti publik ka detyrimin ligjor ti vërë në dispozicion të publikut, por jo në të gjitha rastet janë vënë, janë si më poshtë:

- Mungojnë të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve ose janë të paplota;
- Mungojnë dokumenta që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

- Mungojnë dokumenta të cilat japin informacion apo përshkruajnë kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
- Nuk publikohen të gjitha vendimet dhe njoftimet për qytetarët në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik;
- Mungojnë përshkrime të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit;
- Mungon lista e deklaruar e kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- Mungojnë informacionet lidhur me standardet për cilësinë e shërbimit;
- Informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese.

Bashkia e Shkodrës ka lançuar gjatë muajit Qershor një platformë informative lidhur me mënyrën sesi shpenzohet buxheti në të cilin jepet informacion i detajuar mbi investimet, zonën dhe natyrën e investimit, vlerën e tyre, kontributin e bashkisë dhe të donatorëve, kontraktorët, kriteret e tenderimit, etj. Kjo iniciativë përveçse maksimizon nivelin e transparencës, mundëson gjithashtu orientimin e partnerëve apo donatorëve për të bashkëpunuar apo financuar projekte të ndryshme në fushat prioritare apo aty ku ka mangësi.

Më konkretisht në tabelën e mëposhte paraqiten të gjitha kategoritë e të dhënave të parashikuara në ligj dhe situatën e ofrimit të tyre për të tre bashkitë (Shkodër, Durrës dhe Korçë), si edhe vendin e publikuar dhë të vënë në dispozicion për qytetarët.

MONITORIMI I KATEGORIVETË INFORMACIONIT PA KËRKESË <sup>9</sup>											
Nr	Çështja e monitoruar/ Dokumenti	BASHKIA SHKODËR		BASHKIA DURRËS		BASHKIA KORÇË		Ku/mënyra	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> trasparenca	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> trasparenca	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
		Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo				
I	Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.A	X		X		X					
	Struktura e pagave	X		X		X					
	Funksionet dhe detyrat e Autoritetit Publik	X		X		X					
	Institucionet e varësise	X		X		X					

9. Kategoritë e informacionit të përcaktuara në Ligji I 19/2014 "Për të drejtën e informimit", "Neni 7 Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë".

<p>2. Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.</p>	<p>Ligji nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore",</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>                  Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>                  Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">trasparenca/ligje/fq6</a></p>
	<p>Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit",</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>                  Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>                  Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">trasparenca/ligje/fq6</a></p>
	<p>Ligji 8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale",</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>Bashkia Shkodër: N/A<sup>10</sup>                  Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>                  Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">trasparenca/ligje/fq6</a></p>
	<p>Ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil",</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>Bashkia Shkodër: N/A                  Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>                  Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">trasparenca/ligje/fq6</a></p>
	<p>Ligji 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike",</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>                  Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>                  Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>  <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a></p>

10 N/A (not applicable) është tregues për rastet kur bashkitë nuk e kanë aplikuar/ofruar informacionin sipas detyrimit ligjor.



4	Të dhëna për vëndndodhjen e zyrove të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	Dokument me informacion të detajuar me të dhëna për vëndndodhjen e zyrove të Bashkisë	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>
								Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>
								Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
								Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>
								Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>
								Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
Emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a>	
							Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a>	
							Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	

5	Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve	Strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë;	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al/">http://www.durres.gov.al/</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
		Përshkrimin e procedurave të zgjedhje së tyre;	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: N/A
		Përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A



RAPORT MONITORIMI "TRANSPARENCA DHE PJESMARRJA E QYTETARËVE NË QEVERISJEN VENDORE TË BASHKISË DËRRËS, SHKODËR DHE KORÇË"

6	Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik.	Planet strategjike të punës,	X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera,		X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A
		Dokumenta që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit		X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
7	Të dhëna për buxhetin dhe shpenzimet;	Planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara,	X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Raportet vjetor për zbatimin e buxheti		X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>

8	Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese	VKB "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë";	X		X		X		Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Listën e kontraktave të lidhura;	X	X					Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Shumën e kontraktuar;	X	X					Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;	X	X					Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>	
		Informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e policika të ndryshme.	X	X					Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A	

9	Informacione për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut	Lista e shërbimeve	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
	Standardet për cilësinë e shërbimit	Standardet për cilësinë e shërbimit	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A
10	Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik	Lista e shërbimeve	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
	Formate të gatëshme	Formate të gatëshme	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
11	Përshkrime të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit,	Formate të dokumenteve	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
	Lista e kate-gorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë	Lista e kate-gorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A

RAPORT MONITORIMI "TRANSPARENCA DHE PJESMARRJA E QYTETARËVE NË QEVERISJEN VENDORE TË BASHKISË DURRËS, SHKODËR DHE KORÇË"

12	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve,	Përditësimi çdo 3 muaj i regjistrit	X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A
13	Përshkrim i kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfutuar ato;	Lista e formave të ndihmës shoqërore Procedurat për ti përfutuar Publikimi në faqen Eëb ose mjediset publike	X	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a> Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: N/A Bashkia Korçë: N/A Bashkia Shkodër: N/A Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: Vetëm në sportelin e informacionit

14	Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;	Të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak;	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
		Njoftimet e punësimit me të dhëna sipas përcaktimeve të bëra nga Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil";	X	X	X	X	X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
		Formularë aplikimi	X		X		X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>
		Informacione mbi aktivitetet e Bashkisë;	X		X		X	Bashkia Shkodër: <a href="http://www.bashkiashkoder.gov.al">www.bashkiashkoder.gov.al</a> Bashkia Durrës: <a href="http://www.durres.gov.al">http://www.durres.gov.al</a> Bashkia Korçë: <a href="http://www.bashkiakorce.gov.al">www.bashkiakorce.gov.al</a>

## 3.2 MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli bashkiak sipas ligjint të ri "Për vetëqeverisjen vendore" është autoriteti më i rëndësishëm vendimmarrës në nivel vendor dhe funksionimi i tij në mënyrë transparente dhe demokratike mbetet një nga sfidat e qeverisjes së mirë në nivel vendor. Për të patur një panoramë më të plotë të zbatimit të programeve të transparencës në bashkitë e targetuara janë monitoruar njoftimet për mbledhjet e KB, publikimi i vendimeve të KB në vende publike, por edhe monitorimi i zhvillimit të mbledhjeve të KB. Siç është theksuar edhe më lart në tre bashkitë e targetuara janë monitoruar 9 mbledhje të këshillit bashkiak, më specifikisht 3 në Durrës (Janar, Mars, Qershor), 4 në Shkodër (Shkurt, Mars, Prill, Qershor) dhe 2 në Korçë (Shkurt, Prill).

Në mbledhjet e monitoruara vihet re se pjesëmarrja nuk është shumë e larmishme, pjesëmarrësit zakonisht janë këshilltarët, stafi i bashkisë dhe në disa raste media lokale. Në tre mbledhjet e monitoruara të KB Durrës, vetëm në mbledhjen e muajit qershor pati 1 pjesëmarrës nga shoqëria civile (UNDP) dhe asnjë qytetar apo grup interesi. Situata është e ngjashme edhe në Korçë, ku në dy mbledhjet e monitoruara kanë marrë pjesë vetëm 1 OJF vendore e cila kishte në fokus të saj monitorimin e KB dhe 3 qytetarë. Ndërkohë që në mbledhjet e KB të Shkodrës përveçse mbledhja transmetohet në live stream në median lokale, situata është më e larmishme, në 4 mbledhjet e monitoruara ka patur pjesëmarrës nga grupet e interesit, si më poshtë:

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dt.01.03.2017 moren pjesë 36 anëtarë (nga 51 anëtarë që ka KB), prej të cilëve 17 gra dhe 19 burra. Po ashtu në mbledhje ishin të pranishëm:

- 5 anëtarë stafi të bashkisë (përfaqësues nga zyra juridike dhe drejtoria e shërbimeve sociale)
- 2 përfaqësues të OJF-ve të mjedisit (njëkohësisht ekspert mjedisorë, që kanë hartuar planin për mbrojtjen e bio-diversitetit të Bashkisë Shkodër)
- 2 përfaqësues të shoqërisë civile (në funksione monitoruese)
- 10 përfaqësues të medias lokale (gazetare dhe operatorë)

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dt. 24.03.2017 moren pjesë 26 anëtarë (nga 51 që ka këshilli), prej të cilëve 13 gra dhe 13 burra. Po ashtu në mbledhje ishin të pranishëm:

- 10 antarë stafi të bashkisë (përfaqësues të zyrës juridike dhe të drejtorisë së urbanistikës)
- 15 përfaqësues të Ojfr-ve rinore, student dhe inxhinier të pavarur
- 3 përfaqësues të shoqërisë civile (në funksione monitoruese)
- 12 përfaqësues të medias lokale (gazetare dhe operatorë)

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dt. 20.04.2017 moren pjesë 33 anëtarë, Kryetari dhe sekretari i Këshillit Bashkiak, prej të cilëve 13 gra dhe 20 burra. Po ashtu në mbledhje ishin të pranishëm 25 persona publik (17 gra dhe 8 burra) nga të cilët:

- 5 anëtarë stafi i bashkisë (përfaqësues të zyrës juridike dhe zyrës urbanistike)
- 20 përfaqësues të Ojfr-ve vendore, të rinj dhe qytetarë.
- 7 përfaqësues të medias vendore (gazetare dhe operatorë)

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dt. **30.06.2017** kanë marrë pjesë 27 antarë (nga 51 antarë që ka këshilli), prej të cilëve 11 gra dhe 16 burra, si dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak, sekretari i Këshillit, Kryetarja e Bashkisë Shkodër dhe Nën/ Kryetarja e Bashkisë. Po ashtu në mbledhje ishin të pranishëm 17 pjesmarrës nga publiku:

- 8 përfaqësues të Ojfr-ve dhe qytetare.
- 9 përfaqësues të medias lokale (gazetare dhe operatorë)

Vlen të theksohet se ka probleme me periodicitetin dhe zhvillimin normal të mbledhjeve të këshillit bashkiak çdo muaj siç e parashikon ligji. Kështu për shembull, KB i Durrësit në 6 muaj është mbledhur vetëm 4 herë. Njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak në të shumtën e rasteve dalin në një afat shumë të shkurtër, 2-3 ditë përpara mbledhjes dhe publikohen kryesisht në faqen e website-ve, të cilat jo gjithmonë janë të aksesueshme nga qytetarët, por edhe pa shumë detaje mbi çështjet të cilat do të diskutohen. Në asnjë nga njoftimet për mbledhje të KB nuk theksohet se kush mund të marrë pjesë, por vetëm në njoftimet e Këshillit bashkiak të Korçës theksohet në një fjali që mbledhjet janë të hapura për publikun.

**Gjithashtu shfaqen problematika** të lidhura me zhvillimin normal të mbledhjeve, pothuaj të gjitha mbledhjet fillojnë me vonesë, në një mesatare prej 25-30 minuta dhe jo në të gjitha rastet ndiqen çështjet e parashikuara. Gjatë periudhës së monitoruar, KB i Shkodrës është mbledhur më rregullisht dhe vihet re se ka patur diskutime të larmishme, të cilat kanë nxitur diskutime të shumta dhe kanë ngjallur interes për median dhe publikun.

**Një** element tjetër i rëndësishëm i vënë re gjatë monitorimit lidhet me faktin se këshilltarët vijnë të pa përgatitur mbi çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe vetëm një numër i vogël i tyre i lexojnë më parë projekt vendimet apo planet e ndryshme të cilat duhet të miratohen nga këshilli bashkiak.

**Një** çështje tjetër e monitoruar gjatë mbledhjeve të këshillit bashkiak ishin edhe çështjet gjinore në diskutim ku në shumicën e diskutimeve duket se pjesën më të madhe të tyre e zënë burrat si në përmbajtje dhe në kohë diskutimi, p.sh. në mbledhjen e muajit Mars të KB Shkodër, e cila është deri diku përfaqësuese për të gjitha mbledhjet e e monitoruara në bashkitë e targetuara "Burrat kanë dominuar të gjitha diskutimet, vetëm 2 gra kanë kërkuar fjalën, ku me tepër se kanë ngritur shqetësim, kanë pyetur Kryetaren e Bashkisë, nëse janë bërë të gjitha procedurat para se të miratohet dhe kur do bëhet dëmshpërblimi (në afate kohore)." Koha mesatare që një grua merr në një mbledhje të këshillit bashkiak varion nga 5-10 minuta.

**Vlen** të theksohet se edhe pse në programet e tyre të transparencës bashkitë kanë përcaktuar një larmi të kanaleve të komunikimit, ato mbeten të kufizuara kryesisht në faqet e tyre zyrtare në internet. Bashkitë nuk i publikojnë njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak në këndet e tyre të transparencës, rasti i Durrësit. Ndërkohe vetëm Bashkia e Korçës i publikon njoftimet në të treja mënyrat, pra në internet, media lokale dhe afishimin tek këndi i transparencës në mjediset e bashkisë.

**Lidhur me publikimin e vendimeve** të këshillit bashkiak në momentin



e monitorimit të tre bashkitë e përzgjedhura rezultojnë se i publikojnë rregullisht vendimet e këshillave bashkiake dhe mënyra më e zakonshme për publikimin e tyre mbeten faqet e tyre zyrtare në internet në seksionin e transparencës. Bashkia e Durrësit ka një seksion të dallueshëm specifikisht vetëm për vendimet e këshillit bashkiak.

**Një** komponent tjetër i monitoruar gjatë procesit të monitorimit ishte edhe mbi ndërmarrjen e iniciativave civile dhe peticioneve nga qytetarët apo grupet e interesit për institucionet e QV, Rezulton se në 6 muaj për Bashkinë e Durrës, Korçë dhe Shkodër nuk ka patur asnjë iniciativë të tillë nga shoqëria civile ndërkohë që numri i kërkesave nga qytetarët për Bashkinë si institucion varion nga 10-20 kërkesa për secilën bashki.

**Më** poshtë paraqiten në tabela shkurtimisht situata e njoftimeve për mbledhjet e këshillit bashkiak për të tre bashkitë e targetuara mbi vendin e njoftimit, përmbajtjen dhe shpeshësinë e tyre.

NJOFTIMET PËR MBLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK – BASHKIA DURRËS										
Muaji	Vëndi i Njoftimit				Përbajtja e njoftimit				Sa shpesh	
	Këndi i transparencës	Website/ Facebook	Tjetër-Media lokale/gazeta	Vendodhja/ Oraret	Çështjet që do të diskutohen	Kush mund të marrë pjesë	Tjetër	Çdo muaj	Më rrallë-Sa?	
Janar	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X		
Shkurt	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X		
Mars	N/A	X	N/A	x	X	N/A	N/A	X		
Prill										
Maj										
Qershor	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X		

NJOFTIMET PËR MBLËDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK – BASHKIA SHKODËR												
Muaji	Vëndi i Njoftimit					Përmblajtja e njoftimit					Sa shpesh	
	Këndi i transparencës	Website/Facebook	Tjetër-Media lokale/ gazeta	Vendodhja/ Oraret	Çështjet që do të diskutohen	Kush mund të marrë pjesë	Tjetër	Çdo muaj	Më rrallë- Sa?			
Janar	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				
Shkurt	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				
Mars	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				
Prill	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				
Maj	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				
Qershor	N/A	X	N/A	X	X	N/A	N/A	X				


NJOFITMET PËR MBLIEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK –BASHKIA KORÇË											
Muaji	Vëndi i Njoftimit					Përbajtja e njoftimit				Sa shpesh	
	Këndi i transparencës	Website/Facebook	Tjetër-Media lokale/gazeta	Vendodhja/Oraret	Çështjet që do të diskutohen	Kush mund të mari pjesë	Tjetër	Çdo muaj	Më rrallë-Sa?		
Janar	X	X	X	Jepet orari dhe vendndodhja ku do zhvillohet	Jepen çështjet që do diskutohen sipas rendit që do të ndiqen gjatë mbledhjes së K.B	N/A	Përbajne shpjegime për çështjet që do shqyrtohen dhe komisionet përkatëse të këtyre çështjeve	X			
Shkurt	X	X	X					X			
Mars	X	X	X					X			
Prill	X	X	X					X			
Maj	X	X	X					X			
Qershor	Nuk ka date ende deri në datën 25 Qershor 2017									X	

### 3.3 ANALIZA E INTERVISTAVE ME QYTETARËT

Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje vendore duket se vazhdon të jetë e ulët edhe në bashkitë e targetuara. Nga intervistat e zhvilluara me qytetarët vihet re se ato deklarojnë se kanë pak informacion apo janë disi të informuar mbi aktivitetin e Bashkisë dhe se ndjekin burime të ndryshme të informimit, si sportelet e informacionit në Bashki, media dhe faqen zyrtare në internet. Më poshtë analizohen intervistat e zhvilluara me qytetarët për secilën nga bashkitë e targetuara.


#### 3.3.1 Analiza e intervistave me qytetarët, Bashkia Durrës

Nga qytetarët e intervistuar vihet re se ata janë pak të informuar mbi aktivitetet që organizon Bashkia e tyre me qytetarët si konsultime publike, mbledhje të KB apo edhe aktivitete të ndryshme me interes publik. Vetëm dy qytetarë shprehen se janë shumë të informuar pasi kanë patur kontakte të vazhdueshme me Bashkinë për shkak të interesit të tyre të vazhdueshëm.



**Grafiku 1.** Niveli i informimit mbi aktivitetet që organizon Bashkia Durrës me qytetarët

Lidhur me burimet e informacionit qytetarët duket se përdorin më shumë se një kanal informimi, por dominojnë media lokale dhe kombëtare si edhe faqja zyrtare në internet e bashkisë, si më poshtë:



**Grafiku 2.** Burimet e informacionit të Bashkisë që qytetarët i referohen për të marrë informacion - Durrës


Të pyetur më tej mbi kategoritë e informacionit për të cilat qytetarët kanë kërkuar kryesisht në sportelet e bashkisë Durrës janë si më poshtë:

- Informacion mbi dokumentacionin e nevojshëm që duhen plotësuar për të përfituar strehim nga bashkia; Informacion për shpërndarjen e banesave për të pastrehët.
- Informacion për shërbimet sociale, procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike por dhe ndihmesave të tjera që bashkia ofron për familjet e varfëra;
- Informacion mbi pozicionet vakante të punës dhe formularë të ndryshëm;
- Informacion lidhur me legalizimet tek zyra e mardhënieve me publikun;
- Informacion mbi dëmshpërblimet për pasojat e përmytjeve të vitit 2016 për qarkun e Durrësit, etj.

Ndërkohë qytetarët shprehen se kanë interes të kenë informacion në mënyrë të vazhdueshme nga Bashkia lidhur me oraret e mungesës së ujit dhe të bëhen njoftime të vazhdueshme, për aktivitete që organizon Bashkia ne interes të qytetarëve dhe për mbledhjet e KB, për ndarjen e banesave për të pastrehët, informacion të detajuar mbi shpenzimet e buxhetit të bashkisë dhe investimet publike, si edhe informacion mbi shërbimet sociale.

Të pyetur nëse kanë marrë pjesë në ndonjë nga takimet e Bashkisë të zhvilluara me qytetarët vetëm 6 prej tyre kanë marrë pjesë, dhe takimet kanë qënë për projektin e Velierës, për planet dhe projektet e infrastrukturës, buxheti për shërbimet sociale, për infrastrukturën dhe problematikat e tjera të komunitetit, si edhe në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2016-2017.


Lidhur me faktin nëse kanë kërkuar ndihmë tek strukturat e NJQV, vetëm 5 qytetarë nga 20 janë shprehur se kanë kërkuar ndihmë dhe se e vlerësojnë mënyrën e trajtimit të kërkesës me shpërndarjen si më poshtë:



**Grafiku 3.** Vlerësimi i mënyrës së trajtimit të kërkesës/problematikës/ave nga ana e Bashkisë - Durrës

Ndërkohë të pyetur më tej lidhur me efektivitetin e funksionimit të niveleve të qeverisjes vendore si Bashkia, KB dhe NJA, gjysma


e qytetarëve të intervistuar e vlerësojnë me “mesatarisht mirë” efektivitetin e NJA-ve dhe në nivelin “Mire” KB (8 qytetarë) ndërsa në nivele më të shpërndara vlerësohet efektiviteti i bashkisë.



**Grafiku 4.** Efektiviteti i niveleve të qeverisjes për adresimin e nevojave - Durrës

### 3.3.2 Analiza e intervistave me qytetarët, Bashkia Shkodër


Qytetarët e intervistuar në Shkodër shprehen se janë disi të informuar mbi aktivitetet që organizon Bashkia me qytetarët dhe që mund të jenë në interes të tyre, vetëm 4 prej tyre shprehen se janë shumë të informuar mbi aktivitetin e Bashkisë me qytetarët.



**Grafiku 5.** Niveli i informimit mbi aktivitetet që organizon Bashkia Shkodër me qytetarët



Lidhur me burimet e informacionit më shumë se gjysma e të intervistuarve shprehen se Zyrat me një ndalesë të informimit (one stop shop) në Bashki janë burimi kryesor i informimit, i ndjekur më pas nga informacioni i marrë në faqet zyrtare të bashkisë në web dhe në facebook.



**Grafiku 6.** Burimet e informacionit të Bashkisë që qytetarët i referohen për të marrë informacion - Shkodër

Kategoritë e informacionit për të cilat qytetarët kanë kërkuar informacion, kryesisht në sportelet e bashkisë Shkodër janë si më poshtë:

- Për banesa sociale, për strehim dhe për dokumentat që duhen plotësuar që të përfitojnë këtë status dhe kredi të buta (2 persona);
- Për procedurat e tenderave për kanalizimet dhe kancelari (2 persona);
- Për leje ndertimi, shtesë banese, rikonstruksion (4 persona);
- Pozicionet vakante të punës në sektorin social;
- Informacion për shfrytëzimin e hapsirave publike, zgjerim biznesi;
- Informacion mbi buxhetin e ekipit të futbollit;
- Ankese për parkimet para shtëpive;
- Informacion për dokumentacionin për ndihme ekonomike;
- Informacion mbi menaxhimin e taksave (taksa e ujit);


- Informacion mbi mundësitë e financimit të artisteve të huaj;
- Informacion mbi dokumentat e bashkise, planet e zhvillimit për realizuar një detyë kursi.

Gjithashtu qytetarët shprehen se kanë interes të kenë informacion në mënyrë të vazhdueshme nga NJQV mbi fushat e mëposhtme:

- Transparenca e buxhetit, taksat dhe shërbimet (buxheti për sportin) - 5 persona;
- Për tenderat (2 persona);
- Për kriteret dhe transparençën e lejeve të ndertimit (3 persona);
- Për vende të lira puna;
- Për buxhetin dhe programet për artin dhe kulturën (2 persona);
- Për shërbimet sociale, ndihmën ekonomike dhe banesat sociale (2 persona);
- Për planet strategjike dhe projektet e ndryshme të Bashkisë për qytetin, etj.


Lidhur me pjesëmarrjen në takime të organizuara nga Bashkia me qytetarët, vetëm 2 prej të inetrvsituarve kanë qënë pjesë e këtyre takimeve, ku njëri prej tyre ka qënë takimi për prezantimin e programit të transparençës dhe tjetri për prezantimin e projektit për banesat sociale.

Ndërkohë 14 qytetarë nga 20 të pyetur janë shprehur se kanë kërkuar ndihmë të paktën një herë tek Bashkia dhe 11 prej tyre janë shprehur se nuk mungonte gadishmëria për ta trajtuar kërkesën e tyre, ndërsa 3 prej tyre shprehen se kërkesës së tyre ju dha zgjidhje e menjëhershme. Më konkretisht shpërndarja e përgjigjeve rezultoi si në grafikun e mëposhtëm:



**Grafiku 7.** Vlerësimi i mënyrës së trajtimit të kërkesës/problematikës/ave nga ana e Bashkisë - Shkodër


Sa i përket efektivitetit të funksionimit të niveleve të qeverisjes vendore si Bashkia, Këshilli Bashkiak dhe Njësi Administrative, rreth gjysma e qytetarëve të intervistuar e vlerësojnë si “mesatarisht mirë” efektivitetin Bashkisë dhe të KB dhe rreth gjysma prej tyre nuk kanë informacion mbi efektivitetin e NJA-ve.



**Grafiku 8.** Efektiviteti i niveleve të qeverisjes për adresimin e nevojave - Bashkia Shkodër


### 3.3.3 Analiza e intervistave me qytetarët, Bashkia Korçë

Qytetarët e intervistuar në Korçë shprehen se janë mesatarisht të informuar mbi aktivitetet që organizon Bashkia me qytetarët dhe që mund të jenë në interes të tyre dhe vetëm 4 prej tyre shprehen se janë shumë të informuar mbi aktivitetin e Bashkisë me qytetarët.



**Grafiku 9.** Niveli i informimit mbi aktivitetet që organizon Bashkia Korçë me qytetarët

Të pyetur ë tej mbi burimet e informacionit të cilat qytetarët përdorin për tu informuar mbi aktivitetin e Bashkisë duket se më shumë se gjysma prej tyre kanë si kanal informimi median sociale dhe median tradicionale dhe në një numër më të ulët sportelet e informimit në bashki.



**Grafiku 10.** Burimet e informacionit të Bashkisë që qytetarët i referohen për të marrë informacion - Korçë

Vetëm gjysma e të pyeturve në Korçë kanë raportuar se kanë kërkuar informacion për kategoritë e mëposhtme:

- Informacion për leje për përdorimin e hapsirave publike për tregtinë e artikujve të ndryshëm;

- Dokumentacioni për përfitimin e pagesës së PAK dhe ndihmës ekonomike;
- Informacion lidhur me shërbimet e ofruara për qytetarët;
- Informacion për një vendim të KB;
- Ankesë për taksë të lartë të hapsirës publike;
- Mbi takimet me kryetarin e bashkisë;
- Kërkesë për dokumentacion për festën e birrës;
- Informacione të ndryshme lidhur me taksat vendore dhe lejet e ndertimit;
- Për shpronsimin e pronës për ndërtimet që bëhen në qytet;
- Informacion mbi planin urbanistik
- Informacion mbi taksat vendore;
- Për programet e strehimit për të përfituar shtëpi me kredi të ulët.


Gjithashtu qytetarët e intervistuar shprehen se janë të interesuar të kenë informacion të vazhdueshëm dhe të detajuar nga Bashkia lidhur me taksat dhe pastrimin e lagjeve të qytetit; shërbimet sociale ndaj qytetarëve; për projektet që do të ndërmerren në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së qytetarëve; dokumentat e ndihmës ekonomike dhe programet sociale për të varfërit; rregullimin e rrugëve të qytetit; taksat e bizneseve dhe informacion mbi taksat; shërbimet për qytetarët; politikat dhe shërbimet për të pastrehët dhe mundësitë që ofrohen, etj.

Të pyetur më tej lidhur me pjesëmarrjen e tyre në takime të Bashkisë me qytetarët, 6 prej të inetrvistuarve shprehen se kanë marrë pjesë dhe tematikat kanë qënë si më poshtë:

- Dëgjesa publike për infrastrukturën, punësimin dhe strehimin në fillim të vitit;

- Takim me Kryetarin për problematika të ndryshme të qytetit dhe problematika që shqetësojnë qytetarët;
- Takim për hartimin e buxhetit vjetorë të Bashkisë;
- Dëgjesa publike për sheshin e qytetit e zhvilluar me qytetarët;
- Takim për zhvillimin e turizmit;
- Dëgjesa publike me qytetarët për ndërtimin e bibliotekës së qytetit.


Gjithashtu nga të intervistuarit 14 prej tyre janë shprehur se kanë kërkuar ndihmë në NJQV-të për nevoja apo problematika të tyre dhe 11 prej tyre shprehen se stafet respektive ishin të gatshme për ti dhënë zgjidhje problematikës së tyre. Më konkretisht si në grafikun e mëposhtëm:



**Grafiku 11.** Vlerësimi i mënyrës së trajtimit të kërkesës/problematikës/ave nga ana e Bashkisë Korçë.

Ndërkohë të pyetur më tej lidhur me efektivitetin e funksionimit të niveleve të qeverisjes vendore si Bashkia, KB dhe NJA qytetarët vlerësojnë në nivele më pozitive performancën e Bashkisë dhe në nivele më të ulëta atë të KB dhe NJA-ve.

RAPORT MONITORIMI "TRANSPARENCA DHE PJESMARRJA E QYTETARËVE NË QEVERISJEN VENDORE TË BASHKISË DURRËS, SHKODËR DHE KORÇË"



**Grafiku 12.** Efektiviteti i niveleve të qeverisjes për adresimin e nevojave - Korçë

## KONKLUZIONE

### 4.1 BASHKIA DURRËS

Gjatë periudhës së monitorimit Janar – Qershor të zbatimit të programit të transparencës, monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe intervistave me qytetarët për Bashkinë Durrësit rezultojnë:

- Bashkia Durrës ka të publikuar në faqen zyrtare programin e transparencës, por duhet theksuar se është një program jo shumë i detajuar mbi aktivitetin që do të ndjekë Bashkia lidhur me transparencën.
- Bashkia Durrës ka përcaktuar një person përgjegjës për transparencën, por ajo nuk e dedikon totalisht kohën për këtë pozicion, duke qenë se mbulon edhe detyra të tjera njëkohësisht.
- Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak (data, vendi, dhe çështjet që do diskutohen) publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë, me një mesatare 2-3 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe nuk publikohen në asnjë mjedis tjetër, si p.sh. mjediset e NJA-ve apo në median lokale.
- Njoftimet për mbledhjet e komisioneve të Këshillit Bashkiak



publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë dhe njoftimi është më specifik pasi përmban jo vetëm datën dhe orën e mbledhjes së këtyre komisioneve, por edhe vendin dhe çështjet që do diskutohen.

- Që nga Janari 2017 deri në 20 qeshor 2017 janë realizuar 3 dëgjesa publike për Bashkinë e Durrësit (njoftime të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë) të cilat lidhen me projekt buxhetin 2017 dhe buxhetin afatmesëm dhe planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) gjatë muajit Maj.
- Gjatë periudhës së monitoruar vetëm në dy mbledhje të Këshillit Bashkiak janë ndjekur nga përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të organizatave rinore dhe media, apo grupe të interesit, ndërkohë që nuk ka patur pjesmarrje të qytetarëve.
- Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë iniciativë apo peticion të drejtuar nga qytetarët për Këshillin Bashkiak.
- Lidhur me pjemarrjen e grave në mbledhjet e KB, vihet re që gratë janë aktive dhe diskutojnë për çështjet që lidhen me shërbimet sociale, ndihmën ekonomike, shërbimet si kopshtet dhe shkollat, etj dhe më pak për çështje që lidhen me buxhetin, investimet apo infrastrukturën, etj.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të Bashkisë rifreskohet vazhdimisht brënda afateve ligjore prej 3 muajsh siç e parashikon ligji.

## 4.2 BASHKIA SHKODËR

Gjatë periudhës së monitorimit Janar – Qershor të zbatimit të programit të transparencës, monitorimit të mbledhjeve të këshillit bashkiak dhe intervistave me qytetarët për Bashkinë Shkodër rezultoi:

- Bashkia Shkodër ka të publikuar në faqen zyrtare programin e transparencës dhe është lehtësisht i gjendshëm për publikun.

- Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak (data, vendi, dhe çeshtjet që do diskutohen) publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, por jo në sesionin "Axxhenda e mbledhjes" në kategorinë "Këshilli Bashkiak". Këto njoftime jo gjithmonë gjenden lehtësisht për publikun.
- Njoftimet për mbledhjet e komisioneve të Këshillit Bashkiak, po ashtu publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë, por njoftimi përmban vetëm datën dhe orën e mbledhjes së këtyre komisioneve, por jo vendin dhe çeshtjet që do diskutohen.
- Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak, nuk janë të afishuara në asnjë ambjent të Bashkisë Shkodër (zyrës me një ndalesë - One Stop Shop) dhe aq më pak në ambjentet e Njësiye Administrative, po ashtu njoftimi nuk jepet në asnjë media lokale.
- Që nga Janari 2017 deri në 20 qeshor 2017 janë realizuar vetëm 3 dëgjesa publike (të afishuara në faqen zyrtare të Bashkisë ) lidhur me: 1 - projekt buxhetin 2017 dhe buxhetin afatmesës (dt.24/01/2017), 2 - konsultim me grupet e interesit (24 prill 2017) për miratimin e rregullores dhe funksionimit të komisionit të strehimit; 3 - konsultim publik mbi projektligjin "Për sportin" (dt 17.03.2017) nëpërmjet e-mailit. Keto njoftime nuk janë afishuar në ambjentet e Bashkisë dhe as në ambjentet e Njësiye Administrative.
- Disa nga mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë ndjekur nga përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të organizatave rinore dhe media, apo grupe të interesit, por nuk ka patur pjesëmarrje të qytetarëve.
- Gjatë periudhës së monitorimit nuk ka patur asnje iniciativë apo peticion të drejtuar nga qytetarët për Këshillin Bashkiak.
- Në këndin e transparencës (njoftimeve) në ambjenteve të Bashkisë Shkodër gjenden vetëm njoftime të zyrës juridike "Për shpallje" të individeve për gjyq, por jo informacion tjetër.

- Kërkesat për informacion të paraqitura në zyrën me një ndalesë nga qytetarët, marrin përgjigje brenda afatit ligjor (brenda 5 ditëve të paraqitjes së kërkesës), disa nga kërkesat nuk regjistrohen pasi marrin përgjigje të menjëhershme nga nëpunësit e sporteleve të zyrës me një ndalesë.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të Bashkisë nuk është rifreskuar që nga muaji Mars 2017.

### 4.3 BASHKIA KORÇË

Gjatë periudhës së monitorimit Janar – Qershor të zbatimit të programit të transparencës, monitorimit të mbledhjeve të KB dhe intervistave me qytetarët për Bashkinë Korçë rezultoi se:

- Bashkia Korçë ka të publikuar në faqen zyrtare programin e transparencës i cili adreson parimet e përgjithëshme të transparencës, por jo në mënyrë specifike aktivitetet që do të ndiqen.
- Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak (data, vendi, dhe çështjet që do diskutohen) publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, në rubriken njoftime por jo në kanale të tjera si media lokale apo afishimi i njoftimeve në mjediset e Bashkisë apo NJA-ve.
- Njoftimet për mbledhjet e komisioneve të Këshillit Bashkiak, po ashtu publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë, njoftimi përmban datën dhe orën e mbledhjes së këtyre komisioneve, vëndin dhe çështjet që do diskutohen. Informacioni për mbledhjet mund të merret në mjediset e Bashkisë duke pyetur tek zyra me një ndalesë – (One Stop Shop).
- Të gjitha vendimet e KB janë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë dhe në Infocip-in për trasparencën. Vendimet nuk publikohen në mjediset e Bashkisë por mund të merren si informacion duke pyetur pranë zyrave me një ndalesë.

- Në mbledhjet e zhvilluara të KB gjatë peridhës së monitorimit nuk ka patur pjesëmarrje të qytetareve vetëm të një organizate të shoqërisë civile e cila ka në fokus monitorimin e KB (ARZH) dhe media lokale në disa nga mbledhjet.
- Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë iniciativë apo peticion të drejtuar nga qytetarët për Këshillin Bashkiak.
- Në këndin e transparencës (njoftimeve) në ambjentet e Bashkisë Korçe gjenden kryesisht njoftime në lidhje me aktivitetet e Bashkisë Korçë, shpalljen e vendeve vakante të punës si edhe publikohen hap pas hapi projektet të cilat po kryhen nga Bashkia.
- Kërkesat për informacion të paraqitura në zyrën me një ndalesë nga qytetarët, marrin përgjigje brenda afatit ligjor (mesatarisht 3-5 ditë nga paraqitja e kërkesës), disa nga kërkesat nuk regjistrohen pasi marrin përgjigje të menjëhershme nga nëpunësit e sporteleve të zyrës me një ndalesë.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të Bashkisë është rifreskuar deri në datën 19.06.2017.
- Bashkia Korçë publikon në mënyrë të vazhdueshme njoftime të ndryshme kryesisht mbi aktivitetet të Bashkisë në faqen të zyrtare e Facebook.

## REKOMANDIME

Bashkitë duhet të organizojnë konsultime publike më të shpeshta me qytetarët dhe grupet e interesit dhe jo vetëm për çështjet e detyrueshme nga ligji për qeverisjen vendore.

Bashkitë duhet të marrin masa që të përdorin një sërë kanalesh për informimin e publikut si njoftimet në mjediset e NJQV si p.sh. Njësitë Administrative. Nga monitorimi në asnjë rast nuk ka njoftime pranë mjediseve të NJA-ve dhe pse janë institucionet vendore më pranë qytetarëve.

NJQV duhet të marrin masa që të gjitha njoftimet për konsultimet me publikun ti publikojnë jo vetëm në faqet e tyre elektronike ose ambientet përkatëse, por dhe në portalin <http://www.konsultimipublik.gov.al/>, sipas kërkesave të VKM Nr. 828, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike".

Bashkitë duhet të pajisen urgjentisht me zyra të posaçme për të drejtën e informimit dhe koordinatorët për të drejtën e informimit duhet të jenë pozicione të dedikuara ekskluzivisht dhe duhet të angazhohen për të orientuar dhe nxitur qytetarët në iniciimin e kërkesave për informacion. Shumica e qytetarëve nuk janë të informuar për egzistencën e një koordinatori të tillë. Gjithashtu në këndet e informimit për qytetarët duhet të shpallen regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve me datat përkatëse. Nga monitorimi rezulton se ky regjistër përditësohet vetëm online.

Njohja e koordinatorëve të transparencës me detyrat përkatëse, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i punës së tyre, ashtu si përcaktohet në tre ligjet kryesore që garantojnë transparencën e pushtetit vendor: Ligji nr. 139/2015 'Për Vetëqeverisjen Vendore'; Ligji nr. 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit' dhe Ligji nr. 146/2014 'Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik' si një mënyrë për të garantuar transparencën në nivel vendor.

Bashkitë duhet të informojnë qytetarët për të drejtat e tyre, duke organizuar aktivitete informuese si një mënyrë për ti nxituar ata të marrin pjesë në vendimmarrjen vendore. Në aktivitetet e zhvilluara me qytetarët në Bashkitë e targetuara rezultoi se shumica prej tyre nuk janë të informuar mbi hapsirat egzistuese për ta që garantohen edhe në ligj apo mënyrat sesi mund të informohen dhe të ndikojnë vendimmarrjen vendore.

Bashkitë përmes një zëri të posacëm në buxhetin lokal, duhet të krijojnë mekanizma të nxitjes si (adresarin e letrave, adresarin e komunikimeve online, komunikimeve telefonike, platforma online, etj.), për të zgjeruar numrin e qytetarëve të informuar dhe për pasojë, për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj tyre.

Organizimi i takimeve informuese veçanërisht me të rinjtë dhe nxënësit e shkollave të mesme si një mënyrë për të edukuar të rinjtë me frymën e pjesmarrjes në vendimmarrjen vendore. Fushata ndërgjegjësuese apo aktivitete bashkëmoshatare (nëpërmjet përdorimit të fletëpalosjeve, posterave, videove), me qëllim rritjen e kuptueshmërisë dhe përgjegjësisë qytetare në lidhje me rolin që ata kanë në mirëqeverisje.

Në secilën Bashki të institucionalizohet ekzistenca e Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor, si në praktikën pozitive të Bashkisë Korçë, të përbërë nga përfaqësues të komunitetit dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme, që do të ndihmonte Këshillin por edhe Ekzekutivin në nxjerrjen e akteve vendore sa më lehtë të aplikueshme dhe në të mirë të komunitetit.

Zyra për Informim të angazhohet më tepër për përditësimin e web-faqes zyrtare të Bashkisë me informacione të rëndësishme për qytetarët dhe publikimin më të detajuar në përmbajtje të vendimeve të Këshillit Bashkiak, lidhur me pjesmarrjen, kohëzgjatjen, çështjet e trajtuara, etj.

## BIBLIOGRAFI

Ligj nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Programi i Transparencës i Bashkinë Korçë (<http://www.bashkiakorce.gov.al/>)

Programi i Transparencës i Bashkisë Shkodër ([http:// www.bashkiashkoder.gov.al/](http://www.bashkiashkoder.gov.al/))

Programi i Transparencës se Bashkisë Durrës për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ([www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al/))

BIRN (2016), "Raport Kombëtar "Monitorimi i pushteti vendor nën lënten e të drejtës për informim"

ISP (2016), Raport Monitorimi "Zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit në bashkitë e reja"



## ANEKSI I

### FORMAT BAZË PËR MONITORIMIN E PROGRAMEVE TË TRANSPARENÇËS

SESIONI I II-TË MONITORIMI I PJESMARRJES E QYTETARËVE NË MBLLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK									
2.1 NJOFTIMET PËR MBLLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK									
Muaji	Vëndi i Njoftimit			Përmbajtja e njoftimit				Sa shpesh	
	Këndi i transparencës	Website /Facebook	Tjetër-Media lokale/gazeta	Vendodhja/Oraret	Çështjet që do të diskutohen	Kush mund të mari pjesë	Tjetër	Çdo muaj	Më rrallë-Sa?
Janar									
Shkurt									
Mars									
Prill									
Maj									
Qershor									

SESIONI I II-TË MONITORIMI I PJESMARRJES E QYTETARËVE NË MBLLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK											
2.2 PUBLIKIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK NË NË VËNDE PUBLIKE DHE TË AKSESUESHME PËR PUBLIKUN;											
Muaji	Vëndi i publikimit			Përmbajtja e publikimit						Sa shpesh publikohen	
	Këndi i transparencës	Ëëbsite/ Facebook	Tjetër-Media lokale/gazeta	Vendimi i plote	Informacion mbi pjesmarrësit	Informacion mbi diskutimet e bera	Tjetër	Çdo muaj	Më rrallë-Sa?		
Janar											
Shkurt											
Mars											
Prill											
Maj											
Qershor											

SESIONI I II-TË MONITORIMI I PJESMARRJES E QYTETARËVE NË MBLIEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK									
2.3 NIDËRMARRJEN E INSIATIVAVE CIVILE, KËRKESAT NGA QYTETARËT PËR INSTITUCIONET E QY									
Muaji	Iniciativa qytetare			Mënyra/ Forma			Marrja ne Konsideratë		
	Numri i tyre per secilin muaj	Nga kush (organizata, biznese, grupe ineteresi etc)	Përmbajtja/ tematika për çfarë?	Nëpërmjet një kërkesë me shkrim Bashkise	Kërkesë keshillit bashkiak	Seance degjimore	Tjetër	Përgjigje brënda 3 ditëve nga NJQV	Më Vonë Sa?
Janar									
Shkurt									
Mars									
Prill									
Maj									
Qershor									

SESIONI I II-TË MONITORIMI I PJESMARRJES E QYTETARËVE NË MBLIEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK									
2.4 MARRJA NË KONSIDERATË E PETICIONEVE, KËRKESAVE DHE PËRGJIGJA NË KOHË E TYRË SIPAS KOHËS SË PARASHIKUAR									
Muaji	Kërkesa/peticione			Mënyra/ Forma			Marrja ne Konsideratë		
	Numri i tyre per secilin muaj	Nga kush (organizata, biznese, grupe interesi etc)	Përmbajtja/ tematika për çfarë?	Nëpërmjet një kërkesë me shkrim Bashkise	Kërkesë keshillit bashkiak	Seance degjimore	Tjetër	Përgjigje brënda 3 ditëve nga NJQV	Më Vonë- Sa?
Janar									
Shkurt									
Mars									
Prill									
Maj									
Qershor									

SESIONI I II-TË MONITORIMI I PJESMARRJES E QYTETARËVE NË MBLIEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK									
2.4 MARRJA NË KONSIDERATË E PETICIONEVE, KËRKESAVE DHE PËRGJIGJA NË KOHË E TYRË SIPAS KOHËS SË PARASHIKUAR									
Muaji	Kërkesa/peticione			Mënyra/ Forma			Marrja ne Konsideratë		
	Numri i tyre per secilin muaj	Nga kush (organizata, biznese, grupe in-teresi etj)	Përmbajtja/ tematika për çfarë?	Nëpërmjet një kërkesë me shkrim Bashkise	Kërkesë keshillit bashkiak	Seance degjimore	Tjetër	Përgjigje brënda 3 ditëve nga NJQV	Më Vonë Sa?
Janar									
Shkurt									
Mars									
Prill									
Maj									
Qershor									

## ANEKS 2

### UDHËZUES

#### MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK<sup>11</sup>

- Kush mori pjesë (specifiko OJF, grupet interesi, etj):

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

<sup>11</sup> Në periudhën 6 mujore të monitorimit në kuadër të projektit "Monitorimi i programeve të transparencës në nivel lokal për një qeverisje demokratike" do të monitorohen 4 mbledhje të këshillit bashkiak në secilën bashki të cilat do të jenë mbledhje të hapura për publikun.

- Çështjet e diskutuara (përshkruaj):

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

- A u ndoq axhenda e lajmeruar mbi çështjet që do të diskutoheshin, a pati devijime ose jo, etj (shpjego):

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

- Koha në dispozicion për sugjerime nga palët e interesuara, (si ishte ndarja e diskutimit):

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

- Çështje gjinore në diskutim, Kush zë më shumë kohë në diskutim gratë apo burrat? Për cilat çështje?

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

- Çështje të tjera:

---

---

---

---

---

---

---

---



## ANEKS 3

### INTERVISTË ME QYTETARËT

*Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të projektit “Monitorimi i programeve të transparencës në nivel lokal për një qeverisje demokratike”, cili po zbatohet nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social me mbështetjen e Programit të Granteve të Vogla të Ambasadës Amerikane. SHKPS po zhvillon një monitorim 6 mujor të programeve të transparencës në 3 bashki të vëndit, Durrës, Korçë dhe Shkodër.*

*Të dhënat e mbledhura nëpërmjet kësaj interviste janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për procesin e monitorimit.*

- 1. Sa të informuar jeni mbi aktivitetet që organizon Bashkia me qytetarët?**
  - Aspak
  - Disi
  - Mesatarisht të informuar
  - Të informuar
  - Shumë të informuar

2. **Cilat janë burimet e informacionit të Bashkisë që ju i referoheni për të marrë informacion?**

- Faqa e ëeb në internet
- Faqa në facebook
- Sportelet e informimit në bashki
- Media
- Tjetër

3. **Çfarë lloj informacioni keni kërkuar tek bashkia?**

---

---

---

---

---

---

---

---

4. **Për çfarë kategorie informacioni jeni të interesuar ta keni të vazhdueshëm nga bashkia?**

---

---

---

---

---

---

---

---

5. **A keni marë pjesë në ndonjë takim të Bashkisë me qytetarët? Nëse po çfarë tematike?**

---

---

---

---

---

---

---

---

6. **A keni qënë pjesë e takimeve konsultuese për hartimin e buxhetit të Bashkisë. Nëse po si do e vlerësonit këtë proces?**

---

---

---

---

---

---

---

---

7. **A keni kërkuar ndihmë tek qeverisja vendore (Bashkia/ NJA) për ndonjë problematikë që keni patur?**

1. PO
2. JO
3. Nuk e di
4. Pa përgjigje

8. **Si do ta vlerësonit mënyrën e trajtimit të kërkesës/  
problematikës/ave nga ana e Bashkisë?**

1. Mungonte gatishmëria për të trajtuar kërkesën
2. Nuk mungonte gatishmëria për të trajtuar kërkesën
3. Kërkesës/ave ju dha zgjidhje e menjëhershme
4. Tjetër \_\_\_\_\_

9. **Si do ta vlerësonit efektivitetin e secilit nga nivelet e  
geverisjes për adresimin e nevojave tuaja?**

	Shumë të mirë	Të mirë	Mesatarisht mirë	Të varfër/ dobët	Nuk e di
Njësia administrative					
Këshillit bashkiak					
Bashkisë					